



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: 3 Mars 2023

Nr: 86

Ora: 12:00

V E N D I M

P Ë R

**SHQYRTIMIN ADMINISTRATIV NDAJ PERSONIT PËRGJEGJËS TË BASHKISË KAVAJË, PËR
RAPORTIMIN E VEPRIMTARIVE PUBLIKE, PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES
VENDORE TË DATËS 14 MAJ 2023**

Sot më datë 3 Mars 2023, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve mori në shqyrtim çështjen administrative me:

SUBJEKT: Z. Erjon Lalaj, person përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike në bashkinë Kavajë

OBJEKT: Shqyrtim administrativ ndaj personit përgjegjës të bashkisë Kavajë, për raportimin e veprimtarive publike

BAZA LIGJORE: Në mbështetje të nenit 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f” dhe “n”, pika 2, neneve 91, 92 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, vendimit nr. 9, datë 9.3.2021 dhe vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator

Në përfundim të këtij shqyrtimi,

K O N S T A T O J :

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, më datë 27.2.2023, në adresën e postës elektronike, të Koordinatorit për të Drejtën e Informimit, ka marrë indicie për organizimin e 1 (një) veprimtarie publike nga ana e bashkisë Kavajë.

Indicia është marrë nëpërmjet provave ku pretendohet si në vijim:

Data: 3 Mars 2023

Nr: 86
Ora: 12:00



“Për shqyrtimin administrativ ndaj personit përgjegjës të bashkisë Kavajë, për raportimin e veprimtarive publike”

“Bashkia Kavajë më datë 22.2.2023, ka zhvilluar një veprimtari publike (takim) me banorë në Helmas, të cilën nuk e ka njoftuar paraprakisht në ndërfaqen e KQZ-së.

Kjo veprimtari është postuar në faqen e Kryetarit të Bashkisë Kavajë z. Redjan Krali:

<https://www.facebook.com/RedjanKrali> .

Postimi i bërë ka këtë përmbajtje:

“Helmas, Kavaja është e çdo banori, qytet a njësi qoftë. Është e njerëzve të ndershëm dhe punëtorë që e duan dhe kontribojnë për transformimin e mëtejshëm të saj!

Mirënjohje zemre për cdo shtrengim dore e përqafim që mora sot në Helmas. Besimi juaj është frymëzim për ne! Energjia juaj është garancia për një mandate të. Bashkë jemi më të fortë!

#SkaKohëPërPushim

#14maj (linku i postimit):

<https://www.facebook.com/photo/?fbid=597520338860051&set=pc.597520685526683>)”

Neni 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f” dhe “n” e pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar përcakton kompetencat që ushtron Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve.

Mbështetur në përcaktimet e nenit 8, pika 3, të vendimit nr. 9, datë 9.3.2021, të Komisionit Rregullator, u shqyrtua paraprakisht çështja dhe u vlerësua se informacioni apo të dhënat e treguara krijojnë një bazë të mjaftueshme për të nisur hetimin administrativ.

Më datë 27.2.2023, bashkisë Kavajë i është kërkuar informacion në lidhje me indicien e marrë, nëpërmjet adresës elektronike.

Më datë 2.3.2023, bashkia Kavajë bën me dije se: *“Kryetari i Bashkisë Kavajë z. Redjan Krali me datë 22.2.2023, ka qenë i ftuar nga Partia Socialiste e bashkisë Kavajë dhe nuk është z.Krali organizues i këtij aktiviteti. Siç duket edhe ne fotot e linkut që na keni dërguar aktiviteti drejtohet nga bashkëkryetaret e PS Kavajë z.Shpend Barameta dhe zj. Marinela Alia. Bashkëlidhur ju dërgojmë ftesën nga Partia Socialiste Kavajë drejtuar z.Krali.”*

Nga verifikimi i rrethanave dhe fakteve, rezultoi se bashkia Kavajë nuk është organizatore e aktivitetit të sipër përmendur, për pasojë në referim të legjislacionit në fuqi, detyrimi për raportimin e aktivitetit nuk rëndon mbi këtë institucion. Ky detyrim rëndon mbi institucionet publike, qendrore dhe vendore, si dhe agjencitë dhe/ose ndërmarrjet shtetërore, të cilat duhet të raportojnë në Komisionin Qendror të zgjedhjeve të gjitha veprimtaritë me karakter publik që planifikojnë të zhvillojnë në periudhën 4 (katër) muaj para datës së zgjedhjeve deri ditën e zgjedhjeve.

Për sa më sipër, në mbështetje të dokumentacionit të disponuar, provave dhe fakteve të administruara gjatë hetimit administrativ rezulton se objekti rast hetimi pranë Komisionit

Qendror të Zgjedhjeve ndaj bashkisë Kavajë, nuk përbën shkelje të nenit 92, Kodit Zgjedhor dhe të vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f” dhe “n”, pika 2, nenet 91, 92 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, vendimit nr. 9, datë 9.3.2021, dhe vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve

V E N D O S:

1. Pushimin e procedimit administrativ ndaj z. Erjon Lalaj, person përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike, në bashkinë Kavajë.
2. Moskonstatimin e shkeljes administrative.
3. Rezultatet e këtij vendimi i njoftohen palës nëpërmjet postës elektronike.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI